

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditëses [REDACTED]
[REDACTED] Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqëson
[REDACTED] nga Ferizaj, kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj Rr.[REDACTED], për shkak
të pagimit të borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike, me datë 24.06.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërsi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses [REDACTED]

[REDACTED] Ferizaj dhe DETYROHET i padituri [REDACTED]
[REDACTED] nga Ferizaj Rr.[REDACTED] që në emër të shpenzimit të energjisë elektrike t'ia paguaj
paditëses shumën prej 4,225.41 Euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi, nën
kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësja përmes të autorizuarit të saj ka parashtruar padi me datë 05.12.2013, kundër të
paditurit, për shkak të pagimit të borxhit për shpenzimin e energjisë elektrike.

I autorizuari fillmisht i propozojë Gjykatës që seanca të mbahet për arsyse i padituri
është ftuar me rregull dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, më tutje deklaroi se i padituri është
shfrytëzues i energjisë elektrike dhe se i njejti evidentohet sipas shifrës [REDACTED]. I padituri
e ka shpenzuar energjinë elektrike dhe borxin nuk e ka paguar, ashtu që kompanisë [REDACTED], i
padituri i ka borxh shumën prej 4,225.41 Euro duke filluar nga data 03.02.2013 e deri sot. I
propozojë Gjykatës t'a aprovonë në tërsi kërkesëpadinë e paditëses në shumën e më lartë cekur.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët
ndërgjygjëse përbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-
së, Gjykata në seancën e datës 24.06.2016 ka administruar Faturën [REDACTED] të datës
31.10.2013 dhe transaksioni i konsumatorit i datës 24.06.2016.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se padia e paditëses është në tërësi e bazuar.

Pas vlerësimit dhe administrimit të provave dhe pohimeve të palëve ndërgjygjëse Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i padituri është shfrytëzues dhe shpenzues i energjisë elektrike; se nga data 03.02.2013 e deri në ditën e shqyrtimit i padituri i ka borxh paditëses shumën prej 4,225.41 Euro, këtë Gjykata e vërtetoi gjatë administrimit të provave, përkatesisht nga transaksi i konsumatorit.

Palët në marrëdhënje detyrimore kanë për detyrë të sillen më korrektësi ndaj njeri tjetrit dhe mos ti shkakojnë dëm, ky është një parim shumë i rëndësishëm i marrëdhënjeve detyrimore i paraparë në nenin 12 të LMD-së të vitit 1978, “*në themelin e marrëdhënjeve të detyrimeve dhe në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit kanë për detyrë t'i përbahen parimit të ndërgjegjmërisë dhe ndërshmërisë*”. Është detyrim i të paditurit për përbushjen e detyrimit për shërbimin e marrur nga KEK, për çdo mallë, apo shërbim të marrë në të njejtën kohë lindë edhe detyrimi pagesës së kundërvlerës, kjo parashihet edhe në nenin 17 të LMD-së paragrafi 1 “*Pjesëmarrësit e marrëdhëniës së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përbushjen e tij, përgjegjës për përbushjen e tij dhe paragrafi 2 Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve në marrëdhënien e detyrimit ose në bazë të ligjit*”, pra energjia elektrike konsiderohet si mallë, si çdo mallë tjetër.

Andaj nga të theksuara e më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 305 të Ligjit mbi Marrëdhëni Detyrimore të vitit 1978 dhe nenin 143 të Ligjit për Procedurës Kontestimore.

REPUBLICA E KOSOVES  GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
REPUBLICA KOSOVA C.nr.862/13, me datë 24.06.2016

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ, LUROŠEVAC

21.08.2016

Gjyqtari,
Ardian Ajvazi

Këshilla Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e nesërme pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.